



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:071187
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05865492

Ac.nr.2239/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.K nga fshati D....., Komuna e Gj....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.Y, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M, Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, për kompensimin e pagave jubilarë, kompensimin në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1639/2020 i datës 22.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1639/2020 i datës 22.02.2022, në pikën I të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë që i referohet shpërblimit jubilar dhe gjykohet si në vijim: REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses A.K nga fshati D....., Komuna e Gj....., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që në emër të shpërblimit jubilar t`ia paguaj shumën prej 210.50 euro, në vlerë të një page bazë, si e pathemeltë.

II. REFUZOHET pjesërisht e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1639/2020 i datës 22.02.2022, në pikën I të dispozitivit, lidhur me kompensimin të shpenzimeve për ushqim gjatë punës, udhëtimit, kamatës së gjykuar, si dhe në pikën II të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1639/2020 i datës 22.02.2022, ka vendosur: *‘I.Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditëses A.K nga fshati D..... dhe*

detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses, t'ia paguajë shumën e të hollave lartësi prej 834 €, në emër të kompensimit të ushqimit ditor për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 04.02.2020, respektivisht për 417 ditë të pranisë në punë, në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumë e të hollave në lartësi prej 329€ apo 70% të biletës së trafikut urban si dhe në emër të shpërblimit jubilar shumë e të hollave në lartësi prej 210.50€, respektivisht shumë e përgjithshme prej 1,373.50 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 18.06.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestuese në lartësi prej 260 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi''.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën dhe ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje ose ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësja, përmes të autorizuarit të saj, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës me datë 18.06.2020, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpërblimit jubilar në shumë prej 1,336.4 €. Ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën 23.02.2022 e ka bërë rregullimin – plotësimin e padinë dhe kërkesëpadinë në kuptimin objektiv, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shumën monetare prej 834 €, për ushqim në punë, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 04.02.2020, respektivisht për 417 ditë të pranisë në punë, në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumë e të hollave në lartësi prej 329€ apo 70% të biletës së trafikut urban si dhe në emër të shpërblimit jubilar shumë e të hollave në lartësi prej 210.50€, respektivisht shumë e përgjithshme prej 1,373.50 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 18.06.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të aktgjykimit të ankimuar, nën kërcënim të përmbartimit

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe atyre të nxjerra në seancën e shqyrtimit kryesor, si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin

e atakuar C.nr.1639/2020 i datës 22.02.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të provave të administruara dhe gjendjes faktike të provuar, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar në tërësi, pasi që gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është mësimdhënëse në SHFMU të Muzikës në Gj..... nga data 01.09.2003 dhe vazhdon të punoj edhe më tutje në këtë shkollë, ngase një fakt i tillë vërtetohet nga Kontrata e Punës me nr.të protokollit 1435 e dt.01.09.2015, në të cilën vërtetim përcaktohet përvoja e punës dhe ditët e pranisë në punë. Por kontestuese për palën e paditur ishte se Kontratën Kolektive të Arsimit nuk e kishte nënshkruar e paditura – Komuna e Gjilanit dhe si e tillë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime për të njëjtën si dhe që paditësja e ka paraqitur padinë më datën 18.06.2020, duke u mbështetur në Kontratë kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, që do të thotë ekziston parashkrimi i kërkesës sepse ka kaluar më tepër se tre vite, pas kalimit të afatit të kontratës në fjalë. Në bazë të vërtetimit me nr.05-Nr.10/20 të datës 04.02 2020, vërtetohet se paditësja për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 04.02.2020 ka qenë e pranishme në punë për 417 ditë, ashtu që bazuar në nenin 35 neni 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura duhet t’ia kompensoj shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro në ditë, respektivisht shumën në lartësi prej 834.00 euro, e poashtu t’ia kompensoj edhe shpenzimet e udhëtimit në relacionin Gj.....-D....., 70% të biletës së trafikut urban e cila sipas kuponit fiskal kushton 0,50 centë gjegjësisht shumën e përgjithshme prej 1,373.50€. Faktin e vendbanimit dhe udhëtimit të paditëses në relacionin e cekur me lartë e vërteton certifikata e vendbanimit me numër serik B e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në fshatin D....., Komuna e Gj..... Ndërsa lidhur me kompensimin e shpërbllimit jubilar gjykata e vërtetoi faktin në bazë të listës së pagave me të cilën vërtetohet se pagën bazë e paditëses është 421 €, ndërsa përvojë punë mbi 15 vite ashtu që bazuar në nenin 37 paragrafi 8 pika 8.1 të njëjtës i takon kompensimi në shumë prej 210.05 €.

Për bazën juridike i është referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2022 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, lidhur me kumatën iu referuar nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës iu referua nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, përveç në pjesën e kërkesëpadisë ku aktgjykimi është dashur të ndryshohet.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarës së të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni

logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në bazë të vërtetimit me nr.05-Nr.10/20 të datës 04.02.2020, është vërtetuar se paditësja për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 04.02.2020 ka qenë e pranishme në punë për 417 ditë, e poashtu edhe për shpenzimet e udhëtimit në relacionin Gj.....-D....., 70% të biletës së trafikut urban është vërtetuar sipas kuponit fiskal që kushton 0,50 centë gjegjësisht shumën e përgjithshme prej 329 €. Faktin e vendbanimit dhe udhëtimit të paditëses në relacionin e cekur me lartë e vërteton certifikata e vendbanimit me numër serik B..... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në fshatin D....., Komuna e Gj..... Ndërsa lidhur me lartësinë e pagës gjykata e vërtetoi faktin në bazë të listës së pagave me të cilën vërtetohet se pagën bazë e paditëses është 421 €.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, sa i përket kompensimit të shujtave, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *“ Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në paragrafin 5 të kësaj Kontrate përcaktohet se: *“Punonjësit të kësaj Kontrate përcaktohet se arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”*.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9“*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses

në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës, gjatë ditëve të pranisë në punë dhe udhëtimit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Kjo për arsye se e paditura nuk ia ka paguar ushqimin ditor paditëses për ditët e pranisë në punë, ndërsa nga ana tjetër nuk ia ka siguruar ushqimin të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër si dhe pagesën për udhëtimin për punë, andaj ka obligim kompensimin për ushqim dhe transport për paditësen.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës me ç’rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”,* ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj. në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit bien të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Prandaj, Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e atakuar lidhur me pretendimet ankimore se gabimisht është aplikuar e drejta materiale, gjeti se pretendimet e tilla qëndrojnë pjesërisht vetëm sa i përket shpërblimit jubilar, ndërsa nuk qëndrojnë për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale duke iu referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe atë nenit 35 par.7 të së njëjtës, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke u bazuar në vërtetimin të lëshuar nga vetë e paditura ku për 417 ditë pune ia ka aprovuar shumën 834 €.

Ndërsa sa i përket shpërblimit jubilar, kjo gjykatë vlerësoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për arsye se nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura, rezulton se paditësja ka përvojë pune 15 vite, e cila është në marrëdhënie pune nga viti 2005 e tutje, çka do të thotë se vitin jubilar e ka arritur në vitin 2015, kur asnjë marrëveshje kolektive nuk ka qenë në fuqi, andaj edhe nuk ka mundur ta realizojë një të drejtë, ngase i mungon baza ligjore. Nga këto arsye Gjykata e Apelit e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në këtë pjesë dhe e ka refuzuar

pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses për shpërblim jubilar në shumë prej 210.50 €, e duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në bazë të nenit 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017 përcaktohet se *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, për 20 vjet të përvojës në vlerë të 75 % të një page bazë dhe pika 8.5 e të njëjtës parasheh se: “8.5 Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”*. Në rastin konkret kur paditësja e ka mbushur vitin jubilar, në vitin 2015 nuk ka qenë në fuqi kontrata kolektive.

Kjo Gjykatë pati parasysh edhe pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesës, por vlerëson se as ky pretendim nuk qëndron pasi që paditësi kërkesën e saj e ka parashtruar brenda periudhës kohore 3 vjeçare të përcaktuar me Ligjin e Punës, më konkretisht me nenin 87 ku përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. ndërsa dispozitat e LMD-së siç ka pretenduar e paditura se janë kërkesa mujore nuk mund të zbatohen në rastin konkret, sepse kemi të bëjmë me kërkesa nga marrëdhënia e punës e të cilat kërkesa janë të rregulluara me Ligjin e Punës, i cili zbatohet në kontestet e kësaj natyre, andaj vjen në shprehje afati 3 vjeçar i parashkrimit, e i cili në rastin konkret nuk ka arritur sepse paditësi e ka parashtruar kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim dhe peshë për një vendim ndryshe, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), lidhur me nenin 201 par. 1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2239/2022, me datë 19.06.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca-Dula, d.v.